



**Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opstina Obilic/Municipality of Obiliq**

Bazuar në nenet 6,8,9,10,11,12,13,14,15,16 dhe 17 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave Dhe Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit dhe Aktivitetet Jashtëshkollore me Nr. -I-104, të datës 31.08.2020, dhe kërkesën me nr.-X -645, të datës 09.10.2020, Drejtoria e Arsimit më 09.10.2020 shpall:

KONKURS

(për ndarjen e bursave të studentëve në universitetet publike për nivelet e studimeve themelore-bachelor, master dhe dektoraturës për vitin akademik 2020-2021)

Kushtet dhe kriteret:

1. Të drejtë për bursë komunale kanë studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë banorë të Komunës së Obiliqit.
- Të jenë të regjistruar studentë të rregullt në vitin akademik, për të cilin ndahet bursa

1.1. Niveli i studimeve themelore (bachelor):

1.1.1 Të jenë studentë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve, përjashtim bëjnë, studentët me aftësi të kufizuara, studentët fëmijë të dëshmorëve, studentët jetimë (me një prind ose pa asnjërin prind) dhe studentët familjet e të cilëve janë raste sociale, të cilët përfitojnë bursë edhe për vitin e parë të studimeve, si studentë të rregullt.

1.1.2. Të kenë të regjistruar për herë të parë vitin (gjegjësisht semestrin e vitit) për të cilin ndahet bursa.

1.2. Niveli i studimeve master për drejtimet:

1.2.1 Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore, Departamenti i Matematikës, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Kimisë dhe Departamenti i Biologjisë përkatësisht drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje të Mjedisit;

1.2.2 Fakulteti i Edukimit;

1.2.3 Fakulteti Teknik;

1.2.4 Specializimet në lëmin e mjekësisë;

1.2.5 Arkitekturë dhe Ndërtimtari;

1.2.6 Studentë të të gjitha drejtimeve të studimeve, për të cilët në bazë të mundësive buxhetore në pajtim me nenin 8 vendos komisioni për ndarjen e bursës,

1.2.7 Drejtimet nga pika 1 deri në pikën 5 të nenit 9 do të kenë prioritet në ndarjen e bursave.

1.3 . Niveli i doktoratës:

1.3.1 Nga të gjitha lëmit e studimeve me kusht që të ketë punime shkencore të publikuara në ndonjë revistë shkencore, (përjashtim bëhet për studentët ,të cilët janë në vitin e parë, duhet të dëshmojnë pagesën e semestrit të parë).



Dokumentet e obliguara janë:

- Fletëkërkesa
- Vërtetimi i regjistrimit të vitit akademik,semestrit
- Ekstraktin e lindjes
- Kartela (ID) e studentit
- Vërtetimi i notave dhe nota mesatare nga fakulteti
- Kopja e letërnjoftimit
- Konfirmimi bankar

Dokumentet plotësuese për bonuset sipas kategorive , neni 11 i kësaj rregulloreje

- Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale në Obiliq (vetëm për familjet që marrin asistencë sociale)
- Vërtetimi për prindërin se është dëshmor i UÇK-së
- Vërtetimi për prindërin se është veteran i UÇK-së
- Vërtetimi për prindërin se është invalid i UÇK-së
- Vërtetimin për prindërin se ka qenë i burgosur politik
- Dëshmi se studentit apo studentja është me nevoja të veçanta
- Dëshmi se studentit apo studentja është nga komunitetet pakicë
- Dëshmi se studentit apo studentja nuk ka prindër
- Dëshmi se studentit apo studentja nuk jeton me prindër
- Dëshmi se në familje kanë më shumë se dy studentë
- Certifikata që studentit, studentja është banor i komunës së Obiliqit

Sqarim :Studentët kanë të drejtë përfitimi vetëm në një kategori.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimt të KK-së ,ose në faqe zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në të njëjtën Zyrë. Afati i konkurrimit është 15 ditë pune.

Drejtori :Rexhep Zeka





Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opstina Obilic/Municipality of Obiliq



Drejtoria e Arsimit

Fletëkërkesë për bursa të studentëve për nivelin themelor(bachelor) dhe nivelet master e doktoraturës
(Për vitin akademik 2020-2021)

Emri	
Emri i prindërit	
Mbiemri	
Ditëlindja	
Vendi	
Ardesa e banimit	
Telefoni	
Adresa elektronike	
Fakulteti	
Drejtimi	
Nivelet e studimit (rrumullakso numrin)	1.niveli themelor (bachelor) 2.niveli master 3.niveli i doktoraturës
Nota mesatare	
Emri i prindërit dëshmor i UÇK-së	
Emri i prindërit veteran i UÇK-së	
Emri i prindërit invalid i UÇK-së	
Emri i prindërit ish-i burgosur politik	
Student që ka familjen në asistencë sociale	
Student nga komuniteti pakicë	
Student me nevoja të veçanta	
Student që nuk ka njërin prindër (jetim)	
Student që nuk ka asnjërin prindër (jetim)	
Student që nuk jeton me prindër	
Student që në familjen e ngushtë kanë më shumë se dy studentë (të vërtetohet me nr. të ID e studentit)	1. _____ 2. _____ 3. _____ 4. _____

Dëshmi e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar sipas konkursit të publikuar nga DA	Emri dhe mbiemri i studentit : _____	Data: _____ 2020	Nënshkrimi i Studentit _____
Drejtori në DA	Rexhep Zeka	Nënshkrimi 	